



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:066394

Datë: 23.10.2024

Numri i dokumentit: 06336313

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florid Hasku, me bashkëpunëtoren profesionale Liridona Palushi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve L.L. dhe L.K. që të dyja nga Gjakova, të cilët me autorizim i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë, me objekt kontesti: kompensim i shtesës së inflacionit në pagë, jashtë seancës, me 23 tetor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.L. nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022, t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 737.95 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 15.02.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.K. nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit për periudhën kohore nga data 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022, t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 423,63 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloj të llogaritet nga data 15.02.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses L.K. mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë

në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit, për periudhën kohore nga data 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022, vlerën në shumë prej 314,03 euro.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 332.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditëset, përmes së autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datën 15.02.2023, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditëset janë të punësuar tek e paditura në Shkollën “Zekeria Rexha” në Gjakovë. Në bazë të nenit 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura ka për obligim që për çdo vit të përcjellë shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë të paditësve. Meqë e paditura nuk e ka përmbushur këtë detyrim, paditëset kanë paraqitur padi përmes të cilës kanë kërkuar që t'u kompensohet diferenca e inflacionit në pagë, me kamatë ligjore si dhe i kanë kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me datë 29.04.2024 përmes së autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se ky kompensim paditëseve nuk iu takon as me kontratën e punës, e gjithashtu as me Ligjin e Punës. Sa i përket Kontratës Kolektive ka theksuar se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin e Punës, pasi Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve. Tutje ka shtuar se paditëseve nuk iu takon e drejta e kompensimit të inflacionit pasi në rast të shfaqjes së tij nuk godet vetëm një sektor të punësuarve si në rastin konkret sektorin e arsimit, por e godet tërë aparatit shtetëror. Ka konsideruar se në rastin konkret ka po ashtu parashkrim të kërkesës në të holla, andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës

dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizim të padisë dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditëset të lëshuara nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura në Shkollën “Zekeria Rexha” në Gjakovë. Bazuar në Listat e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet se lartësia e pagës bazë e paditëses L.L. është shuma prej 421.00 euro, ndërsa për paditësen L.K. është shuma 241,68 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjeti se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 21.11.2022, ku në mënyrë identike në nenin 35 par.10 kanë përcaktuar se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve iu takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi një dispozitë e tillë është e karakterit imperativ dhe si e tillë do të duhej që shkalla e inflacionit të llogaritet në pagë, marrë parasysh që nga lista e pagave që gjendet në shkresat e lëndës, nuk rezulton që një pagesë e tillë është kryer nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke pasur parasysh të dhënat e nxjerra nga Enti i Statistikave të Kosovës sa i përket shkallës mesatare vjetore të inflacionit, përkatësisht ngritjes së inflacionit ndër vite dhe atë duke filluar llogaritjen nga viti 2020 deri në vitin 2022 (brenda kërkesës së paditësve) sipas përlllogaritjes si në vijim:

Për paditësen L.L.;

- Për periudhën shkurt-dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditëses e cila në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 9.26, apo 0.84 euro për muaj ($421.00 * 0.2\% * 11 = 9.26$)
- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 421.84 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 172.11 euro, apo 14.34 euro për muaj ($421.84 * 3.4\% * 12 = 172.11$).
- Për periudhën janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 436.18 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 556.57 euro, apo 50.60 euro për muaj ($436.18 * 11.6\% * 11 = 556.57$).

Për paditësen L.K.;

- Për periudhën shkurt-dhjetor 2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, andaj duke e llogaritur në pagën bazë të paditëses e cila në vitin 2020 ka qenë 241,68. euro, i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 5,32, apo 0.48 euro për muaj ($241.68 * 0.2\% * 11 = 5,32$)
- Për periudhën janar-dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2021 do të duhej të ishte 242,16 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë për periudhën 12 mujore në total të jetë 98,80 euro, apo 8,23 euro për muaj ($242,16 * 3.4\% * 12 = 98,80$).
- Për periudhën janar-nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke e llogaritur pagën e paditëses sipas shtimit dinarik e cila në vitin 2022 do të duhej të ishte 250,40 euro, atëherë i bie që shuma e inflacionit që është dashur të

futej në pagën bazë për periudhën 11 mujore në total të jetë 319,51 euro, apo 29.05 euro për muaj ($250,40 * 11.6\% * 11 = 319,51$).

Duke qenë se mes palëve nuk ishte kontestuese gjendja faktike përkatësisht se paditëset janë të punësuar tek e paditura dhe se në periudhën nga data 01.02.2020 deri me datë 21.11.2022 në pagën e paditësve nuk është përfshirë edhe shkalla e caktuar e inflacionit, të cilat fakte nuk i ka kontestuar as e paditura në përgjigjen në padi, edhe përkundër faktit se e njëjta e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I, II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit mbi bazën e inflacionit, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila bazohet në Ligjin nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëseve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Pretendimin tjetër të të paditurës lidhur me atë se inflacioni godet tërë aparatit shtetëror e jo vetëm sektorin e arsimit, gjykata e konsideron si të parëndësishme, për arsye se çështja e përfshirjes së inflacionit në pagën e punëtorëve të arsimit është e rregulluar me KKAK, andaj është jo relevante se nga këto kushte goditet nga shkalla e inflacionit, për aq kohë sa e drejta e paditësve për ta kërkuar këtë kriter të kompensimit rrjedh nga dispozitat e kontratës kolektive të lartcekur.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, gjykata gjeti se ky pretendim është i pa bazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditëset kompensimin mbi bazën e inflacionit e kërkon për periudhën nga data 01.02.2020-21.11.2022, ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 15.02.2023, pra brenda afatit prej tre (3) viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës, për periudhën e lartcekur.

Sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht për paditësen L.K. shumës në lartësi prej vlerën në shumë prej 314,03 euro, gjykata të njëjtën e refuzoi për shkak se paditësja as me padi, as në precizimin e padisë nuk ka prezantuar prova materiale për të vërtetuar këtë lartësi të kërkesës, sipas detyrimit të përcaktuar me nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. E për më tepër, gjykata përlllogaritjen e përfshirjes së inflacionit në pagën bazë e ka filluar nga viti 2020, duke shtuar normën e inflacionit vit për vit deri në vitin 2022 (*shtimi dinarik*), për çka rezultoi se pjesa e kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën IV të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 të LPK-së, me ç’rast paditësve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 332.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 156.00 euro si dhe për

përpilimin e precizimit të padisë shumë 156.00 euro, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

2023:066394 më 23 tetor 2024

Gj y q t a r i

Florid Hasku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.